



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 66/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT
BASHKIMI EUROPIAN-SHQIPËRI PËR PJESEMARRJEN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, ME CILËSINË E VËZHGUESES, NË PUNËN E AGJENCISË
SË BASHKIMIT EUROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE DHE MËNYRËN
E KËSAJ PJESEMARRJEJE NË KUADRIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT
(KE) NR. 168/2007**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe
Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi European-Shqipëri për pjesëmarrjen e Republikës
së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit European për të
Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit
(KE) nr. 168/2007, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë në Bordin Drejtues të Agjencisë së Bashkimit
European për të Drejtat Themelore emërohet nga Ministri i Drejtësisë, sipas parashikimeve të
Rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 3.10.2019